

Kujdesi mjekësor

Kush sëmuret ose ka një aksident, duhet të shkojë në të shumtën e rasteve fillimisht te një mjek apo mjeke familjeje. Për sëmundje ose aksidente të lehta juve ju ndihmojnë edhe në barnatore. Vetëm në raste vërtet të rënda emergjence duhet të shkoni drejtpërsëdrejti në spital.

Barnatoret

Barnatoret shesin barna me recetë (të lëshuar nga mjeku) dhe të gjitha barnat e tjera. Për një sëmundje të lehtë rekomandohet të shkoni së pari në një barnatore. Farmacistet dhe farmacistët janë të shkolluar mirë dhe ofrojnë këshilla për klientët e tyre. Një barnatore emergjente është gjithmonë e hapur, kështu që mund të merrni barna edhe në raste emergjente. Për t'ju informuar se cila barnatore emergjente është e hapur, mund të telefononi në numrin 0800 300 001 (pa pagesë).

Mjekja familjare / Mjeku i fëmijëve

Në Zvicër, shumë njerëz e kanë një mjek familjar. Ai e njeh historinë personale të sëmundjeve dhe është pika e parë e kontaktit në rast të problemeve shëndetësore. Për fëmijët ka mjeke dhe mjekë të fëmijëve. Nëse është e nevojshme, mjeku do t'i udhëzojë pacientët te mjekë specialistë ose në spital. Vetëm në raste të rënda emergjente duhet shkuar direkt në spital. Për të gjitha rastet e tjera urgjente, në kantonin Aargau ekziston një numër qendror i urgjencës jashtë orarit të punës së ordinancave mjekësore. Ky mund të arrihet 24 orë në ditë në numrin e telefonit: 0800 401 501 (pa pagesë).

Mjeku i dhëmbëve

Normalisht ju duhet të paguani vetë për trajtimet e dhëmbëve. Megjithatë, ekziston mundësia për të bërë një sigurim shtesë, që mbulon trajtimet e dhëmbëve. Fëmijët, që shkojnë në shkollë, kanë të drejtë për një kontroll dhëmbësh në vit, që është pa pagesë. Informacione për këtë temë mund të merren nga shkolla.

Spitali / Stacionet e emergjencës

Nëse dikush ka nevojë për të shkuar në spital, në shumicën e rasteve ai regjistrohet nga një mjeke apo mjek. Përjashtim bëjnë rastet e rënda emergjente, në të cilat duhet shkuar direkt në stacionin e emergjencës së spitalit. Nëse gjendja është me rrezik për jetën ose pacienti duhet të bartet, duhet të telefononi në numrin e emergjencës 144. Për rastet më pak të rënda mjekja ose mjeku familjar është kompetent.

Përkujdesja në shtëpi

Persona të sëmurë ose me nevoja për përkujdesje, që kanë nevojë për përkrahje në shtëpi, mund të përfitojnë nga shërbimet e infermierisë jashtëspitalore (Spitex). Profesionistët shkojnë në shtëpi te pacientet dhe pacientët për të përkujdesur për ta ose për t'iu ndihmuar në punët e shtëpisë. Oferta iu drejtohet personave, që kanë nevojë për mbështetje për shkak të një sëmundjeje, aksidenti, problemeve të moshës, komplikimeve gjatë shtatzënisë ose pas lindjes. Shpenzimet mbulohen pjesërisht nga sigurimi bazë. Përveç Spitex Verband Aargau ka shumë ofrues të shërbimeve private Spitex.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

dev.hallo-aargau.ch/sq/shendeti/sherbimit-mjekesore